Ii-1783

REXHEP HOXHA

MBI KRAHËT E FLUTURËS

Mbi krahët e fluturës

„Libri im"

BIBLIOTEKA PËR FËMIJ E TË RIJ

4

REXHEP HOXHA

MBI KRAHËT E FLUTURËS

RILINDJA
SIPËRMARRJE GAZETARE-BOTUESE
PRISHTINË — 1959

SHKRIMTARË SHQIPTARË



Ilustrator

MIOMIR ZUBIQ

AGIMI

Mbrrini agimi.
Rrugëve, kah bjen,
i lajmon njerzit:
dielli po vjen.

Iu afru' Lulit
edhe e zgjoi:
— Ngrehu, Lul, ngrehu!
Nata kaloi.

E luli ngrihet,
zgju' nga agimi,
me t'drandofiltat
rreze gëzimi.

DIELLI

Dielli, Dielli!
Lindi Dielli.

Oh, sa gzim e sa gazmend!
Rreze t'arta
Derdh prej qielli
Në çdo skutë e në çdo vend.

Nëpër fushë e nëpër male
Dielli luen me lule t'kuqe.
Gzojnë livadhet e vesueme,
Gzon e vogla Pilipuçe.

Dielli, Dielli!
Lindi Dielli.

pilipuçe-ja = gjâ e vogël, e hajme; femën pilipuçe

MARSI

— Po çka ka bora?
Ka mbetë balushë.

— Ia mbrrini marsi
në mal e fushë.

— Ku janë kandilat
strehëve ngri?

— T'friguem prej marsit,
janë tretë e shkri.

— Po çka ka veri?
Nuk fryn si n'fruer.

— Era e jugut
krahët ia muer.

ERA E JUGUT

Fryni er'`e jugut,
borën na e shkrini.
S'po më dhimbet bora
sepse vjen gjelbrimi.

Mâ shum po më dhimbet,
o ti lum Koleci,
që s'bashku me borën
ik dhe Dordoleci.

PRANVERA

Erdhi pranvera,
vashëz e ré,
me duer të bardha,
gëzim për né.

Bleroi kodra
edhe kodrina.
Stolisi pyjet
me bukurina.

Lulzoi brigje,
ograja, fusha.
I çeli vjollcat
nëpër gëmusha.

Lulzoi pjeshka,
thana, lulmona.
Çeli zymbyla
n'kopshtije tona.

Erdhi pranvera,
vashëz e ré,
me duer të bardha,
gëzim për né.

PRILLI

Ia mbrrini prilli
me gjelbrim veshë.
Mbi male Dielli
me rreze qeshë.

Nëpër livadhe
bletët nxitojnë.
Ato fatbardhe
mbi lule gzojnë.

Ky muej i bukur
gjithkend ka gzuem
si zojën flutur
me krahë të shkruem.



MBI KRAHËT E FLUTURËS

— Kaploi drita
fusha e ograje,
Sutë e vogël,
çupëz e pafaje;

zgjohu! Dielli
në çdo anë shëndrit,
nusja lalës
kolikut shetit.

Thonë kush ngrihet
heret, ik prej nate,
prej agimit
ka shpërblim dy fate.

Ngrehu çupëz,
hyp mbi krah't e mija
t'dalim pakëz
nëpër ato vrrija.

Kang' e zogjvet
tash kudo jehon.
Erë prej lulesh
gjithkund kundërmon.

— Uf, moj flutur,
krahlehta piklake,
ta them t'drejtën
se jam shum herake.

Por, s'dij, diçka
Morfeu m'paska gjetë,
me lulkuqin
m'ka mashtru' me fjetë.

Hajde flutur,
oj nuse piklake,
pash gëzimet
tua fluturake,

t'dalim, t'dalim
zemra kah t'na doje,
n'për livadhe,
brigje, fusha, kroje;

ndër zabele,
ku këndojnë bylbylat
e kopshtije,
ku çelin zymbylat;

nëpër rrmore,
ara e ledina,
rrahe, lluga,
kodra, shavarina

e çuterre,
prroje e burime
e goleshe,
gryka me blerime

e arrnjete
e pemishte tjera,
që me lule
stolisi pranvera.

Oh, sa bukur,
sa mëngjes i qetë!
Oh, sa bukur,
sa gjallni e jetë!

Çupëz, çupëz,
shpejt, pra, m'u armisë,
hyp mbi krahët,
— koha âsht m'u nisë!

— Shife, shife
atje n'at shullâ!
— Boboreshat
vallzojnë hiç pa prâ.

— Tuj mbledhë vjollca
shiqoe at mec!
— A mshefë n'çufërr
si me qenë turrec.

— Ndër ledina
ngjoj, diçka ushton!
— Asht traktori,
tokën thellë lëvron.

Oh, sa bukur,
sa mëngjes i qetë!
Oh, sa bukur,
sa gjallni e jetë!

kolik-u = shpat mali
me kundërmue = me lëshue erë të mirë
Morfeu = hyu i gjumit, kishte për simbol kulkuqin.
Rrëmore = Vende të dashuna nga bimësija, vende rrëgallë, rrëpina
Shavarina = Vende me shavar, lloj prej të cilit bâhen hasrat
çuterr-i = prrue i vogël
golesh-i = kodrinë e vogël e padrûj.
m'u arnisë = m'u bâ gati.
boboreshë-a = mizë përdhecke
mec-i = fëmi i vogël
çuferr-a = kaçubë-a

QERSHIJAT

Ka reshë pranvera
qershija t'kuqe
nëpër kopshtije
të vendit tim.

E vashëzat, vashëzat,
çupëzat mitare,
ia kanë nisë kangës
n' t'bukrin blerim.

O vashëza, vashëza,
çupëza mitare,
qershija t'kuqe,
haré . . . haré . . . !

Nisni dhe vallen
mâ gëzimtare
n'pranverë të bukur,
në stinë të re!

mitar = e bukur, e përfytyrshme

BYLBYLI I OGRAJËS

Bardhi zuni nji bylbyl.
Bylbyli zû t'qajë.
— Ç'ke që qan, more bylbyl?
— Due t'jem n'ograjë.

Bardhi bylbylin e lshoi.
Ai fluturoi n'ograjë.
Kangës gzimit ia filloi.
Dhe s'iu ndi mâ vajë.

PUTPUTAÇI

— Mirë mëngjesi,
Putputaç!

Putputaçi kcen.

— Putputaç,
turp s'të vjen?!

Putputaçi kcen.

— Mirë mëgjesi! —
i thom prap.

Putputaçi ik me vrap.
Put. Put. Put.

Putputaç-i = lloj zogu shumë i vogël, që jeton gjunjive. Bën **put, put, put.**



FLUTUR, FLUTUR...

Flutur, flutur
vashë
e bukur,

ti e gzueme
unë
e gzueme
për k'to fusha
të blerueme,

ti e bardhë
unë
e bardhë,
lum pranvera
që ka ardhë,

ti e kuqe
unë
e kuqe
për livadhet
me burbuqe.

Flutur, flutur,
vashë
e bukur,

qofshim mot
qofshim
vjet,
qoftë pranvera
për f'mi t'vet.



LEJLEKU

— Lejlek, lejleku,
më thuej të lutem,
me fluturim tandin,
qiellit çka ban?

— Provoj a mundem
me fluturue
naltsive t'bardha
si aeroplan.



GËZIMET E NJI MAJIT

Erdhi Nji Maji,
oh sa lumni!
Delni n'parada,
o shokë, fëmi!

N'për rrugë e sheshe
yj t'kuq ndriçojnë.
Flamujt e punës
kudo valojnë.

Qeshin qytetet,
katundet mbarë;
qesh dhe traktori
ku punon n'arë.

Lokomotivës
stolisun kuq,
qinda vagona
i bâhen krushq.

Nëpër fabrika
sirena bret:
— Pritshim Nji Majin
me vjet e vjet.

Erdhi Nji Maji,
oh sa lumni!
Nji Maji — lule
për puntorí.

RINIJA E VENDIT TIM

O shokë, rinija
e vendit tim
âsht si pranvera
që sjell lulzim.

Asht sikur yjet,
që lozin n'qiell,
âsht sikur vera,
që nxen me diell.

Asht sikur kanga,
që më dëfren;
âsht si dëshira,
që më ngashjen.

O shokë, rinija
e vendit tim,
âsht jeta ime
mbush plot me gzim.

FLOKËARTA

Lumja un e lumja
për tezen Hajri!
Shif çka m'paska çue
për vjetin e ri!

Nji kukull të bukur
— kukull fustankuqe,
që kam me ia ngjitë
emnin Pilipuçe.

Shifni se sa bukur
rrobet i mban veshë!
Shifni me gojë t'vogël
se sa ambël qeshë!

Shif'nia syt e kaltërt
si yje i sh'ndrijnë!
Shfn'ia flok't e artë
krela-krela i rrijnë!

Qielli ka shum yje,
dimni ka shtërgatë.
Pilipuçja ime
i ka flok't e artë.

FUSTANKUQJA

Bardhja vogël
fustankuqe
âsht imtake,
pilipuçe.

Mirëpo Bardhes
ç'i mungon,
kurse prindët
i nderon?

Ajo, gjithkund,
ku të jetë,
me buzëqeshje
përshëndetë.

Kur nis nata
prej nesh t'eci,
Bardhja zgjohet
si turreci.

Sa âsht dita,
lumja ditë,
kurr kot Bardhja
nuk baritë.

Asht imtake,
por me hire —
Bardhja vogël
dashamire.

imtake = e hajthme
me baritë = me hecë kot.

DRINI

O Dri i kulluem
i vendlindjes sime,
lum për ujnat tua,
t'bardha, si agime.

Tepër unë të due,
un, dakol i yt,
që me mija herë
në ty kam ra zhyt.

Shtratit tand ti hecë
dalë e me ngadalë.
Prej shkëlqimesh t'duket
shkuma në çdo valë.

Prej brigjeve dukesh
lum i paqelira,
kah hecë laqe-laqe
me ujna të dlira.

Gjarpno laqe-laqe
Drini ynë i qetë,
vendit tim të bukur
jepi dritë e jetë.

dakol = i fortë, trim
i paqelira = i pagënjeshtra.

LEPUROSHI

Deshti lepuroshi
t'bâjë nji mrekulli:
të vishet me tesha
po sikur njeri.
Veshi pantallone,
këpucë e jelek,
n'Zvicër porositi
sahat me qystek.
Mirë, porse të ngratit
i shkoi puna huq,
sepse veshët e gjatë
s'i ndejtën n'kapuç.

LUANI

— Çka ka Luani,
qan mu si klysh?

— Paj, në mësime
ka marrë nji dysh.

— Kujtoi veç loja
diçka i bjen?

— Qe, s'mendoi fare
dyshi si vjen.

DËSHIRA

Shpendi e Mentori
tepër kanë dëshirë
ma u bâ kur t'rriten
traktorista t'mirë.

M'u bâ traktorista
t'dejë e t'pamahí —
— mos t'ua kalojë
kush as n'Metohí.

Për dëshirë të tyne
gjithë katundi flet.
Tash ka mbetë të shofim
sa do t'kenë vullnet.

LOKJA

— Lulash i nanës,
kah shkon në shkollë,
prej fatkeqsivet
rueju, oj mollë!

T'kesh kujdes, zemër,
syt mirë me i çelë,
farë qerrje rrugës
mos po të shkelë.

Me t'ndodhë e keqja,
çka bâj pa ty?
Veç me marrë malet
me humbë me kry.

T'kesh kujdes, loke,
nana të flet.
Pranverën lokja,
për ty e pret.

LECI VIZATUES

Lecit i shkon dore
dhe vizaton shpesh
veçanrisht qershija,
kur janë kalavesh.

Viziton qershija
aq bukur, moj nanë,
sa, kur i shef syni,
t'hidhet me i ngranë.

TELEFONI

Lulja dësh'ron tepër
t'flasi n'telefon
sidomos n'foshnjore
kur ajo qëllon.

— Alo, alo, Kukull,
a je në shtëpi?
Shiqo mirë, të lutem,
mos të bâjsh shaki!

Bane u halite
e mos me ndëgjue,
nuk t'bij karamele
që të kam premtue!

GAZI I GJYSHES

— Gjysheloke, t'â zbardhë kryet,
ndoj borë mos ka ra?
Gjyshja qeshë me të madhe:
— Me ujë e kam la.

— Edhe unë flokët i laj,
s'më zbardhen aspak!
— Prit atëherë, tash je i vogël,
duhet t'bâhesh plak.

KANGA E KARCELLIT

Xër, xër,
Xër, xër!

— Ç'thot karcelli?
pyet
Mikelli.

— Tashti yjet
n'qiell shëndrijnë.
T' gjithë fëmija
n'gjum le t'bijnë!

Xër, xër,
Xër, xër!

Mik' i vogël,
për çdo nat',
n'gjon karcellin
t'bjeri n'shtrat.

Mik' i vogël
n'shtrat andrron.
Pranë karcelli
i këndon.
Xër, xër,
Xër, xër!

PUNA E PLEQVET

— Ç'ban, oj halla Nepë?
— Po i mbjelli do qepë.

— A po mund lum bija?
—Ma fort se Zylfija.

— Ç'ban, o mixha Nue?
— P'e mbjelli këtë ftue.

— Paj, plakë tek je burrë!
— Puna s'plaket kurrë.

— Ç'ban, oj nana Razë?
— Jam k'e nxâ do mazë.

— A ke re t'gjet't vera?
— Ajo ka punë tjera.

Halla Nepë
mbjell qepë.

Mixha Nue
mbjell ftue.

Nana Razë
nxen mazë.

FLUTURIMI I NJERIUT

Mija, mija vjetë
njeriu ka mendue,
naltësive t'qiellit
si me fluturue.

E, mbas mija vjetësh,
mâ n'fund ia ka mbrri,
t'zbulojë aeroplanin
t'fluturojë n'hapsi.

Tash hesht Himalaja,
deti, oqeani,
naltësive t'qiellit,
kur shkon aeroplani.

Edhe kontinentet
shiqojnë si fëmiu,
sipër, sipër revet,
kur ngjitet njeriu.



TRAKTORISTI

Heret, heret, pa lé dielli,
sulmuesi Abaz,
çohet edhe merr traktorin,
niset n'arë me gaz.

Agimi me duer të bardha
fusha, male zgalë;
kurse kangën e gëzimit
Abazi s'e ndalë.

— Traktorist jam, thot Abazi
shum puntor jam unë.
— Disa hektarë, mbrenda ditës,
i mbjelli me grunë.

KUKUBECI

— N'mes të kopshtit
me perime,
kukubec çka pret?

Kukubeci s'flet.

I afrohem lehtë,
lehtë.
— Ndalou!
Mos më thot.

Kukubeci,
— kot.

Ia nduku mjekrrën e zhyeme.
Kukubeci s'luen.
Ia zdesh malotën e shqyeme.
Kukubeci s'luen.

— Kukubec,
mos je memec?
Kukubeci
s'flet. S'flet. S'flet.

Kukubeci —
— kukubec. . .

MJEKU

Dritës i dhemb koka.
Uf, sa âsht vështirë!
Mulne shpejt te mjeku
se i ban mâ mirë!

Mulne shpejt te mjeku,
nana le ta çojë —
se mjeku i dashtun
shpejt do ta shërojë.

RIGA

Riga, riga! Po bien shi.
— Ani, po le t'bjerë!
Po, do t'lagemi fëmi?
— Teremi mejherë.

Lagen kopshtet me pemije.
— Po, le t'lagen, vlla!
Rriten prrockat me lumije,
— Po, mujmë not me ra.

Ret po báhen dikah n'qiell.
— Mbas shiut mirë âsht shum.
Po, zhegitemi me diell,
— Freskohemi n'lum.

XIXILLOJA

Xixilloja
për çdo verë
endet natën
me fenerë.

Dron se territ
s'shef me hecë
e fustani
n'ferrë i ngecë.

As fortuna
me fishkllimë,
kurr fenerin
sun ia shtimë.

Kur shkon nata,
që s'shef terrin,
xixilloja
fik fenerin.

me shtimë = me fikë



TOPI

Rrushi ka nji top,
nuk âsht fort i madh.
Kur ban ditë e bukur,
luen me tê n'livadh.

Don ta kalojë topin
për kërcim të naltë,
porse topi larëm
âsht shum mâ i shkathtë.

Ndërsa topi kërcen
sa nji harabel,
Rrushi vogël gjuhet
vetëm sa nji gjel.

KULAÇI

Shoqe, shoqe,
lumja shoqe!
At kulaçin
vetë e poqe.
Vetë e poqe,
mori kloqe,
me e ngranë
s'thirre shoqe!
Shoqe t'mira
me na thanë,
bashk' kulaçin
kishim ngranë.

PATANI

Ga, ga — ga karis patani —
fmi bamirës âsht Mirani!
Për çdo ditë kujdes e banë
me m'qitë diçka për me ngranë.
Mirëpo, unë ç'ti jap dhuratë?
Veç me i ble nji çokollatë!
Por, prap mâ mirë âsht m'e msue
nëpër ujna me notue.
Do ta msoj t'voglin Miran
me notue dhe n'oqean!



LOKOMOTIVA

N'gjo, lokomotiva,
sa mundet tërfatë!
Mirë. Porse nuk lodhet.
Punon ditë e natë.

Han bukë t'zezë, si futa,
n'punë s'e ndal as nata.
Ujë nuk pin me kofa,
por me tonelata.

Hecë nëpër fusha,
futet nëpër male;
ngreh dheta vagona
lisa e metale.

Bán me mija njerëz,
e nuk lodhet dot.
N'vend për me pushue,
— A ka tjetër? — thot.



MOLLA DHE ERA

— Ndale erë fërfllimen,
der' ku don me mbërrijtë?
Shif! M'i shkunde mollat,
s'kanë çka hanë fëmijt. —

Por er' e tërbueme
mollën nuk e ndjeu.
U përplas për mali,
njanën kambë e theu.

Po sa u ndal era
kambën me shërue —
— nisen mollat shpejt
degëve m'u kuqlue.



BRETKOCA

Kua, kua, kuak!
Kam nji dhimbë në bark.
Kua, kua, kuak!
S'mund kërcej aspak.
Kuku n'vend po mbes,
kuku, mos po vdes!

Kue, kue, kuek!
A gjindet kund mjek?
Kue, kue, kuek!
Ma bini nji mjek!
Barkun ta shëroj,
prej vdekje t'shpëtoj.

Kua, kua, kuak!
S'kam kurrgjâ në bark.
Kue, kue, kuek!
Më shëroi nji mjek.
Kcej edhe mâ shum
kllum e kllum në lum.

ÇIZMET E KUQE

— Babë, shife lejlekun!
Ka hy n'mes moçali,
krejt ka me u zhytë —
i thot babës djali.

— Hajt, hajt, o lum biri,
pse shiqon at shpend?
Ai ka çizme t'kuqe,
s'zhytet n'asnji vend!

Mâ mirë shif vetvedin,
more djal i ngratë
që ngajherë krejt rrobet
n'lojna i përbaltë!

PRENDIMI

— Kicirībë,
Dielli ku shkoi?
— Mbrapa malit
perëndoi.

Prej idhnimit
Cicamiu,
nisi vajin:
ciu, ciu!

— Ç'iu desht Diellit
me prendue?
— T'lindi nesër
me na gzue.

Prej gëzimit
Cicamiu,
nisi kangën:
ciu, ciu.

PËRMBAJTJA

	Faqe
Agimi	5
Dielli	6
Marsi	7
Era e jugut	8
Pranvera	9
Prilli	10
Mbi krahët e fluturës	11
Qershijat	15
Bylbyli i ograjës	16
Putputaçi	17
Flutur, flutur	18
Lejleku	20
Gëzimet e nji majit	21
Rinija e vendit tim	22
Flokëarta	23
Fustankuqja	25
Drini	26
Lepuroshi	27
Luani	28
Dëshira	29
Lokja	30
Leci vizatues	32
Telefoni	33
Gazi i gjyshes	34
Kanga e karcellit	35
Puna e pleqvet	36
Fluturimi i njeriut	38
Traktoristi	39
Kukubeci	40
Mjeku	42
Riga	43
Xixilloja	44
Topi	45
Kulaçi	46
Patani	47
Lokomotiva	49
Molla dhe era	50
Bretkoca	51
Çizmet e kuqe	52
Prendimi	53

BIBLIOTEKA E TETIT HIVZI SULEJMANI PRISTINË

REXHEP HOXHA

MBI KRAHËT E FLUTURËS

Redaktor teknik
SKËNDER HOXHA

Korektor
NAZMI SAHITI

Tirazhi 2000 copë
U shtyp në tetuer 1959 në Shtypshkrojën
e Sipërmarrjes gazetare-botuese „RILINDJA" Prishtinë